



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:072350

Datë: 31.07.2019

Numri i dokumentit: 00436935

P.nr.17/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, gjyqtari Sulltan Dobraj e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurit A H nga fsh. S K-D, i akuzuar sipas PTH-ës nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.2678/2018 te dt.04.01.2019** për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPK-ës, mbajtjes së shqyrtimit fillestar me **dt.16.07.2019** ne praninë e prokurorit te shtetit Ersan Qavolli dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 31.07.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **A H**, i lindur me dt. .. në fshatin S k-D, ku dhe tani banon, i biri i H dhe nënës H e vajzërisë D, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ESHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt.27.06.2018 në fsh. B k- D, dëmton pasurinë tjetrit dhe atë të dëmtuarit Q N, në atë mënyrë që i pandehuri ne cilësinë e punë kryesit ne firmën "A", për asfaltimin e rrugës, i kontraktuar nga komuna e Deçanit, për deri sa po e zgjeronte rrugën me ekskavator, del jashtë pikave te vendosura për rrugë dhe hynë 5 m, ne brendi te livadhit, ku përgjatë mezhdës ne gjatësi rreth 100 te livadhit rrezon disa drunjë te llojit arre dhe bagrem, te cilat ishin te mbjella, me çrast te dëmtuarit i shkakton dem material.

- **Me çka ka kryer veprë penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPK-ës.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 85, 86 nenit 333 par.1 te KPK, nenit 498, 499 te KPPRK-ës, të pandehurit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me këtë vërejtje gjyqësore te pandehurit i behet me dije se e ka kryer një vepër te dëmshme dhe te rrezikshme qe përbenë vepër penale dhe nëse kryen prapë një vepër te tille, gjykata do te shqiptoj sanksion me te rende penal.

I pandehuri obligohet që në emër te paushallit gjyqësorë te paguaj shumën prej 25 euro, ne emër te fondit për kompensimin e vikamave te kriminit te paguaj shumën prej 30 euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës penale gjykata do te vendos me aktvendim te veçantë nëse gjënë shpenzime te tilla.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Peja me propozim akuzën e vetë **PP/II.nr.2678/2018 te dt.04.01.2019** akuzuar te pandehurin A H nga fsh. Sllup k-Deçan për veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPK-ës, ka propozuar të caktohet seanca e shqyrtimit gjyqësore të administrohen të gjitha provat e duhura e më në fund i pandehuri të shpallet fajtorë dhe te dënohet ne baze te ligjit si dhe te detyrohet në pagesën e shpenzimeve procedurale-penale.

Me dt.16.07.2019 është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi fillestar në të cilin shqyrtim i pandehuri e ka pranuar fajësinë.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar dhe ka konsideruar se me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit e duke u bazuar edhe nen provat tjera te cilat ndodhin ne shkresat e lendes ne tersi është vërtetua se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet ne barrë, andaj gjykatës i ka propozuar që ta shpallë fajtor ta dënoi ne baze te ligjit, ndërsa pranimi i fajësisë merret si rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: shprehi keqardhje, premtion se në të ardhmen nuk do të ndodhin vepra te tilla.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: me dt.27.06.2018 në fsh. B k- D, dëmtion pasurinë tjetrit dhe atë të dëmtuarit Q N, në atë mënyrë që i pandehuri ne cilësinë e punë kryesit ne firmën "A", për asfaltimin e rrugës, i kontraktuar nga komuna e D, për deri sa po e zgjeronte rrugën me ekskavator, del jashtë pikave te vendosura për rrugë dhe hynë 5 m, ne brendi te livadhit, ku përgjatë mezhdës ne gjatësi rreth 100 te livadhit rrezon disa drunjë te llojit arre dhe bagrem, te cilat ishin te mbjella, me çrast te dëmtuarit i shkakton dem material.

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do të shpallet fajtor për veprën penale të lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do të këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barre, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht ne kuptim te nenit 257 te KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se e pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë konform nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPK-ës, ka konstatuar se i pandehuri është përgjegjës për këtë vepër penale, ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për këtë vepër penale, i ka shqiptuar vërejtjen gjyqësorë.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese, te cilat mund te ndikojnë ne lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj te pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, premtimi i te pandehurit se në të ardhmen nuk do të ndodhin vepra te tilla, i pa dënuar më parë, ndërsa si rrethanë renduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të pandehurit, dhe ne këtë mënyrë do te ndikoj ne arritjen e qëllimit të dënimit të paraparë me nenin 41 dhe 85 të KPRK-së, si mase për rehabilitimin e te pandehurit por edhe si mase për parandalimin e te pandehurit dhe personave te tjerë kryes potencial te veprave penale nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen.

Në bazë të nenit 453 të KPPK-ës, gjykata e ka obliguar që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 25 euro, në emër të fondit për kompensimin e vikamave te krimit te paguaj shumën prej 30 euro, ndërsa për shpenzimet e procedurës penale gjykata do te vendos me aktvendim te veçantë nëse gjënë shpenzime te tilla.

Duke u bazuar në të lartcekurat u vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P. nr.17/2019 te dt.31.07.2019**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e marrjes, drejtuar gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.